



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labiot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së		
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL		Data: 18.08.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave		Nr.020-545/7
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave		
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave		
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit		
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 366105-22776 për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMIJE DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

Nr. Br. / No. 3592-2/20
Nr. i flet. Br. sh. / No. 02
Data / Datum / Date 18.08.20
Prashirë-Prishta-Prishtina No.

HYRJESE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES / VLADA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date 18.08.2020

Kyja e origjinalit / Original / Original No. / Lendës Shënime Vlera
- 18-08-2020-575/7

Për :	Goran Rakić, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Mentor Sylmeta, ud.Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lloji i aktit:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Minister,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr.366105-22776 për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020
I miratuar me datë:30.07.2020
I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:03.08.2020
I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 05.08.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se Ligji Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nuk parasheh lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social, mirëpo, vendimi i arsyetuar për shkak të situatës së krijuar pas shfaqjes së virusit COVID-19, Kuvendi Komunal i Glllogocit, mund të marrin përgjegjësinë në kompetencat e tyre për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr 366/05 - 28776 dt. 30/07 2020

Bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, *nenit 34. Pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit*, nenit 3 pika 1.1 , nenit, 9 Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, nenit 2, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shpalljes së virusit COVID-19, si pandemi, Vendimit Nr. 01/07, Nr. 01/09, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimit 01/11 të datës 15.03.2020, për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë .30.07. 2020,miratoi këtë:

V E N D I M

Për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet lirimi i familjeve përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm social në Bllokun I dhe II në Komunën e Drenasit nga obligimi i pagesës së qirasë joprofitabile për vitin 2020.

Neni 2

Familjet e liruar nga qiraja joprofitabile për vitin fiskal 2020 janë të përcaktuara/përfshira në Vendimin e Kuvendit Komunal 12Nr.360-68569 të datës 29.11.2019.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj